

UNMIK/REG/2002/4 20 Shkurt 2002

RREGULLORJA No. 2002/4

PER

TATIMIN MBI TE ARDHURAT PERSONALE NE KOSOVE

Përfaqesuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në përputhje me autoritetin e dhënë atij sipas Rezolutës 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të datës 10 Qershor 1999,

Duke marrë parasysh Rregulloren Nr.1999/1 të datës 25 Korrik 1999 të Misionit të Përkohshëm Administrativ të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), pas ndryshimeve, mbi Autoritetin e Administratës së Përkohshme në Kosovë, Rregulloren Nr.1999/16 të UNMIK-ut të datës 6 Nëntor 1999, pas ndryshimeve, mbi Autoritetin Qëndror Fiskal dhe Çështje të Tjera të Lidhura si dhe Rregulloren Nr.2000/20 të UNMIK-ut të datës 12 Prill 2000 Mbi Administratën dhe Procedurat Tatimore,

Duke marrë parasysh autoritetin përfundimtar të Përfaqesuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm sipas paragrafit 8.1 (c) të Rregullosës Nr.2001/19 të UNMIK-ut të datës 15 Maj 2001, Mbi Kornizën Kushtetuese për Vetë-Qeverisje të Përkohshme në Kosovë, për të përcaktuar parametrat financiare dhe politike për Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës, si edhe faktin se Institucionet e Përkohshme Vetë-Qeverisëse nuk janë ndërtuar plotësisht dhe nuk kanë mundësi që nëpërmjet Këshillit Ekonomik dhe Fiskal të japin këshilla mbi çështje të mbuluara nga kjo rregullore,

Me qëllim të vendosjes së Tatimit mbi të Ardhurat Personale mbi të ardhurat nga pagat si një hap i parë drejt një tatimi gjithpërfshirës mbi të ardhurat personale që mbulon të gjitha burimet e të ardhurave,

Nëpërmjet kësaj Rregulloreje shpall sa vijon:

Neni 1 Përkufizime

“I punësuar” nënkupton një individ, pavarësisht nëse është apo jo rezident në Kosovë, i cili fiton të ardhura nga pagat në lidhje me punësimin në Kosovë dhe përfshin titullarë qeveritarë, zyrtarë dhe drejtorë kompanish.

“Punëdhënës” nënkupton një person që i paguan paga, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose nëpërmjet dikujt tjetër, një të punësuar për shërbimet e bëra në lidhje me punësimin në Kosovë, dhe përfshin:

- (a) Çdo njësi qeveritare;
 - (b) Çdo organizatë biznesi qoftë kompani ose partneritet;
 - (c) Çdo organizatë biznesi që operon me asete publike dhe shoqërore;
 - (d) Çdo njësi e përhershme e një personi jo-rezident;
 - (e) Një organizatë jo-qeveritare e regjistruar me UNMIK sipas Rregullosës Nr. 1999/22 e UNMIK e datës 15 Nëntor 1999 mbi Regjistrimin dhe Operimin e Organizatave Jo-Qeveritare në Kosovë;
 - (f) Organizatat Ndërkombëtare, zyrtar ndërlidhëse dhe misionet diplomatike të qeverive të huaja;
- dhe

(g) Një individ që paguan paga gjatë kryerjes së një biznesi në Kosovë.

“Njesi e Përthershme” nënkupton një vendpunishte nëpërmjet të cilës një person jo-rezident kryen biznes në Kosovë. Kjo përfshin por nuk kufizohet vetëm në uzinat, zyrat degë, zyrat përfaqësuese, fabrikat, dyqanet dhe vendet e ndërtimit.

“Person” nënkupton një person natyral ose ligjor.

“Punëdhënësi Kryesor” nënkupton një punëdhënës të caktuar si të tillë nga i punësuar në kohën dhe mënyrën e përmendur në udhëzimin administrativ që do të lëshohet nga Autoriteti Qëndror Fiskal. Një individ duhet të ketë vetëm një punëdhënës kryesor në një kohë të caktuar.

“Rezidenca” do të kuptohet si më poshtë:

- (a) Një individ është rezident në Kosovë nëse ky individ:
 - (i) Ka vendqendrimin kryesor në Kosovë; ose
 - (ii) Është prezent fizikisht në Kosovë për 183 ose më tepër ditë në një periudhë tatimore.
- (b) Një kompani ose partneritet është rezident në Kosovë nëse:
 - (i) Është themeluar në Kosovë; ose
 - (ii) Vendi efektiv i menaxhimit ndodhet në Kosovë.

“Tatimpagues” nënkupton një individ që fiton të ardhura të tatueshme në Kosovë gjatë periudhës tatimore.

“Periudha Tatimore” nënkupton vitin kalendarik.

“Pagat” nënkupton çdo shumë të paguar nga punëdhënësi, në para të gatshme ose në natyrë, si kompensim për shërbimin e kryer nga një i punësuar gjatë punësimit, pavarësisht nëse ka ose jo një kontratë të shkruar punësimi. Pagat përfshijnë rrogën, shpërblimet, bonuset, komisionet ose çdo formë tjetër pagimi në lidhje me punësimin.

Neni 2 **Të Ardhurat e Tatueshme**

Të Ardhurat e Tatueshme do të jenë të Ardhurat Bruto të tatimpaguesit gjatë periudhës tatimore minus Zbritjet e Lejueshme sipas kësaj rregullore.

Neni 3 **Të Ardhurat Bruto**

3.1 Të ardhurat bruto sipas kësaj rregullore përfshijnë të gjitha të ardhurat e marra ose akruara në formën e pagave gjatë periudhës tatimore, përveç të ardhurave të përjashtuara në Nenin 4.

3.2 Të ardhura bruto nga pagat do të përfshijnë por nuk do të limitohen në:

- (a) Rrogat e paguara nga ose në emër të punëdhënësit për punën e bërë nga i punësuar sipas udhëzimeve të punëdhënësit;
- (b) Bonuset, komisionet, dhe forma të tjera kompensimi që një punëdhënës, ose dikush tjetër në emër të punëdhënësit, i paguan të punësuarit mbi rrogën;
- (c) Të ardhurat e fituara sipas kontratave për punë të përkohshme;
- (d) Pensionet dhe të ardhura të tjera të paguara nga punëdhënësi i mëparshëm ose nga qeveria;
- (e) Të ardhurat nga një punësim i ardhshëm, si psh një bonus për nënshkrimin e kontratës;

- (f) Prim sigurimi që punëdhënësi paguan për një të punësuar;
- (g) Faljen e borxhit ose obligimit të të punësuarit ndaj punëdhënësit;
- (h) Pagesën e shpenzimeve personale të të punësuarit; dhe
- (i) Përveçse kur përmendet ndryshe nga kjo rregullore, benefitet në natyrë që një punëdhënës i jep të punësuarit, e cila tejkalon shumën minimale të specifikuar në udhëzimin administrativ që do të lëshohet nga Autoriteti Qëndror Fiskal.

3.3 Të ardhurat bruto nga pagat nuk do të përfshijnë:

- (a) Kontributet e detyrueshme të paguara nga punëdhënësi për një skemë fondesh pensioni të aprovuar nga autoriteti kompetent qeveritar;
- (b) Rimbursimi i shpenzimeve aktuale të udhëtimeve biznesore në përputhje me rregullat e specifikuar në udhëzimin administrativ që do të lëshohet nga Autoriteti Qëndror Fiskal;
- (c) Kompensimet për aksidentet në punë;
- (d) Rimbursimi ose kompensimi për trajtimin ose shpenzimet mjeksore, përfshi këtu shtrimin në spital dhe mjekimin, të pagueshëm duke u bazuar në sigurimin shëndetsor ose të paaftësisë për punë, ose në përputhje me ligjin e aplikueshëm, përveç pagave të paguara gjatë periudhës së mungesës në punë për shkak të sëmundjes ose dëmtimit; dhe
- (e) Përfitimet në natyrë që punëdhënësi i jep të punësuarve të huaj për të lehtësuar jetesën e tyre në Kosovë (si psh, akomodimi në shtëpi, pagesat e shkollave)

Neni 4 **Të Ardhurat e Përgjashtuara**

Të ardhurat e mëposhtme sipas kësaj rregulloreje do të jenë të përjashtuara nga tatimi:

- (a) Pagat e marra nga përfaqesues të huaj diplomatikë ose konsullorë dhe personeli i huaj i Zyrave Ndërlidhëse në Kosovë, siç është përcaktuar në Rregulloren Nr. 2000/42 të UNMIK-ut të datës 10 Korrik 2000 mbi Vendosjen dhe Funksionimin e Zyrave Ndërlidhëse në Kosovë;
- (b) Pagat e marra nga përfaqesues të huaj, titullarë të huaj dhe të punësuar të huaj të organizatave ndërkombëtare qeveritare dhe organizatave ndërkombëtare jo-qeveritare me status përfitimi publik;
- (c) Pagat e marra nga përfaqesues të huaj, titullarë të huaj dhe të punësuar të huaj të agjensive donatore ose kontraktorët e tyre ose të grantuarit që merren me ndihma humanitare, punë rindërtuese, administrim civil ose asistencë teknike në Kosovë;
- (d) Pagat e marra nga të punësuarit e huaj dhe lokalë të rekrutuar nga Kombet e Bashkuara, Agjensitë e tyre të Specializuara dhe Agjensia Ndërkombëtare e Energjisë Atomike, që për qëllime të kësaj rregullore do të përfshijnë personelin e huaj dhe vendas të rekrutuar në UNMIK ashtu siç përcaktohet në Rregulloren 2000/47 të UNMIK-ut të datës 18 Gusht 2000 mbi Statusin, Privilegjet dhe Imunitetin e KFOR-it, UNMIK-ut dhe Personelit të tyre në Kosovë; dhe
- (e) Pagat e marra nga personeli i huaj i KFOR-it.

Neni 5 **Zbritjet**

Kontributet e detyrueshme të të punësuarit për skemat e fondeve të pensionit të aprovuara nga autoriteti kompetent qeveritar do të lejohen si zbritje nga të ardhurat bruto.

Neni 6
Përqindjet e Tatimit mbi të Ardhurat

6.1 Për vitin tatimor 2002, tatimi mbi të ardhurat prej datës 1 Prill 2002 do t'i ngarkohet të ardhurave të tatueshme në përqindjet e mëposhtme:

- (a) Për të ardhurat e tatueshme deri në 600 Euro, përqindja është 0%;
- (b) Për të ardhurat e tatueshme ndërmjet 600 dhe 3000 Euro, përqindja është 5%;
- (c) Për të ardhurat mbi 3000 Euro, 120 Euro plus 10% të shumës mbi 3000 Euro.

6.2 Për periudhën tatimore 2003, dhe vitet pasuese, tatimi mbi të ardhura do t'i ngarkohet të ardhurave të tatueshme në përqindjet e mëposhtme:

- (a) Për të ardhurat e tatueshme deri në 600 Euro, përqindja është 0%;
- (b) Për të ardhurat e tatueshme ndërmjet 600 dhe 3000 Euro, përqindja është 10%;
- (c) Për të ardhurat e tatueshme mbi 3000 Euro, 240 Euro plus 20% të shumës mbi 3000 Euro.

Neni 7
Tatimi i Mbajtur në Burim dhe Çertifikata e Tatimit të Mbajtur në Burim

7.1 Çdo punëdhënës duhet të jetë përgjegjës të mbajë në burim tatimin nga të ardhurat nga pagat e të punësuarve të tij gjatë çdo periudhe pagese.

7.2 Një punëdhënës që është punëdhënësi kryesor i të punësuarit duhet të mbajë në burim një shumë për periudhën e kryerjes së pagesës, në përputhje me tabelat e mbajtjes së tatimit në burim siç do të përcaktohen në udhëzimin administrativ që do të lëshohet nga Autoriteti Qëndror Fiskal.

7.3 Tabelat e mbajtjes së tatimit në burim do të llogarisin një tatim në tentativë të bazuar në pagat kumulative të projektuara që do të paguhën gjatë vitit nga punëdhënësi kryesor dhe duhet të zbriten nga ky tatim në tentativë shumat e tatimit të mbajtura në burim nga punëdhënësi kryesor për periudhat e mëparshme të pagesave për atë vit.

7.4 Një punëdhënës që nuk është punëdhënësi kryesor i të punësuarit duhet të mbajë në burim një shumë të barabartë me 10% të pagave për periudhën tatimore 2002, dhe 20% të pagave për periudhën tatimore 2003 dhe vitet pasues.

7.5 Çdo punëdhënës duhet t'i japë brënda 1 Marsit të vitit që pason periudhën tatimore një çertifikatë të tatimit të mbajtur në burim çdo të punësuarit prej të cilëve është mbajtur në burim një tatim mbi paga gjatë periudhës tatimore. Çertifikata e mbajtjes në burim do të jetë në formën e specifikuar në udhëzimin administrativ që do të lëshohet nga Autoriteti Qëndror Fiskal dhe do të përmbajë informacion rreth pagave të paguara dhe tatimit të mbajtur në burim në lidhje me atë të punësuar.

Neni 8
Obligimi për të mbajtur Regjistrime

Çdo punëdhënës duhet të mbajë llogari për tatimin e mbajtur në burim për çdo të punësuar dhe duhet të mbajë libra dhe regjistrime që do të specifikohen në udhëzimin administrativ që do të lëshohet nga Autoriteti Qëndror Fiskal.

Neni 9
Deklarimi dhe Pagesa Tatimore

9.1 Çdo punëdhënës duhet të dorëzojë një pasqyrë të tatimit të mbajtur në burim dhe të paguajë shumën e saktë të tatimit të mbajtur në burim në Administratën Tatimore brënda 15 ditëve pas ditës së fundit të muajit kalendarit, në përputhje me formularin dhe procedurat që do të specifikohen në udhëzimin administrativ të lëshuar nga Autoriteti Qëndror Fiskal.

9.2 Çdo punëdhënës duhet të dorëzojë një pasqyre vjetore përmbledhëse tatimore në Administratën Tatimore brënda 30 ditëve në fund të periudhës tatimore me informacion rreth pagave të paguara dhe tatimit të mbajtur në burim dhe pagimin sa i përket çdo të punësuar, në përputhje me formularin dhe procedurat që do të specifikohen në udhëzimin administrativ që do të lëshohet nga Autoriteti Qëndror Fiskal.

9.3 Çdo tatimpagues, përveç tatimpaguesit mbi të cilët aplikohet neni 9.4, duhet të dorëzojnë një deklaratë tatimore, së fundmi më 1 Prill të vitit që pason periudhën tatimore, ku përmenden të ardhurat e tij/saj të tatueshme dhe shumën e tatimit të paguar gjatë periudhës tatimore, në përputhje me formën dhe procedurat që do të specifikohen në udhëzimin administrativ që do të lëshohet nga Autoriteti Qëndror Fiskal.

9.4 Një tatimpagues nuk do të kërkohet që të dorëzojë një deklaratë tatimore sipas nenit 9.3 kur punëdhënësi(t) e tij/saj kanë mbajtur në burim të gjithë tatimin në lidhje me të ardhurat e tatueshme dhe kur nuk detyrohet më tepër tatim apo ka te drejte per rimbursim.

9.5 Nëse tatimi i mbajtur në burim nga pagat e një tatimpaguesi në lidhje me periudhën tatimore është më i ulët se tatimi për t'u paguar në përputhje me nenin 6, atëherë tatimpaguesi duhet që në kohën e dorëzimit të deklaratës tatimore sipas nenit 9.3 të paguajë diferencën ndërmjet tatimit për t'u paguar dhe tatimit të mbajtur në burim.

9.6 Nëse tatimi i mbajtur në burim nga pagat e një tatimpaguesi është më i lartë se tatimi për t'u paguar në përputhje me Nenin 6, atëherë tatimpaguesi do të ketë të drejtën e një rimbursimi të shumës së mbajtur teper në burim.

9.7 Vendi për të dorëzuar deklaratat tatimore, për të paguar tatimet dhe për të kërkuar rimbursimet do të specifikohet në udhëzimin administrativ që do të lëshohet nga Autoriteti Qëndror Fiskal.

Neni 10

Inspektimi i Regjistrimeve, Vlerësimet Tatimore, Mbledhja e Detyruar

10.1 Administrata Tatimore mundet që në përputhje me Rregulloren Nr. 2000/20 të UNMIK-ut dhe aktet shtesë, të kërkojë prodhimin e dokumentave ose informacioneve të tjera në lidhje me pagat dhe tatimet e mbajtura në burim prej të punësuarve.

10.2 Administrata Tatimore mundet që në përputhje me Rregulloren Nr. 2000/20 të UNMIK-ut dhe aktet shtesë, të lëshojë një Njoftim-Vlerësimi dhe Kërkese per Pagese ndaj personave përgjegjës për të mbajtur në burim dhe paguar tatimin ndaj Fondit të Konsoliduar të Kosovës nëse ata dështojnë të dorëzojnë një deklaratë ose te bëjnë pagim të rregullt.

10.3 Administrata Tatimore e autorizuar nga Rregullorja Nr. 2000/20 e UNMIK-ut dhe aktet shtesë, mund të përdorë metodat e Mbledhjes se Detyruar për të mbledhur tatimet nëse një punëdhënës ose tatimpagues dështon të paguajë shumën e saktë të tatimit të detyruar.

10.4 Fuqitë e Administratës Tatimore sipas këtij Neni nuk do të aplikohen sa i përket punëdhënësve që janë organizata qeveritare ndërkombëtare, misione diplomatike ose zyra ndërlidhëse të qeverive të huaja.

Neni 11
Shkeljet, Ndëshkimet dhe Interesi

11.1 Çdo tatimpagues ose punëdhënës që bën një shkelje sipas Rregullores Nr. 2000/20 të UNMIK-ut dhe akteve shtesë, duhet t'i nënshtrohet ndëshkimit që aplikohet në atë rast, dhe kjo si shtesë ndaj çdo ndëshkimi dhe interesi që mund t'i ngarkohen sipas këtij neni.

11.2 Çdo punëdhënës i përgjegjshëm për mbajtjen në burim, llogaritjen ose pagimin e tatimit të mbajtur nga pagat do t'i nënshtrohet një ndëshkimi prej 5% të tatimit të pambajtur në burim, ose të mbajtur por të papaguar, për çdo muaj mospagimi.

11.3 Nëse një punëdhënës dështon të mbajë në burim tatimin nga i punësuar siç kërkohet në Nenin 7, dhe/ose dështon të bëjë pagesën e tatimit të mbajtur në burim siç kërkohet në Nenin 9, ose vonon mbajtjen në burim ose pagimin, atëherë do t'i ngarkohet interes per ndryshimin ndërmjet tatimit të kërkuar për t'u mbajtur në burim dhe paguar dhe shumës aktuale të paguar për periudhën e mospagimit, në përputhje me normat komerciale të huazimit në Kosovë sic do te lajmërohen publikisht herë pas herë nga Administrata Tatimore.

11.4 Nëse një tatimpagues që kërkohet të dorëzojë një deklaratë tatimore sipas Nenit 9.3 dështon të veprojë kështu, ose e dorëzon deklaratën por dështon të bëjë pagesën në përputhje me Nenin 9.5, atëherë do t'i ngarkohet interes per ndryshimin ndërmjet tatimit për t'u paguar dhe tatimit të mbajtur në burim për periudhën e mospagimit, në përputhje me normat komerciale të huazimit në Kosovë sic do te lajmërohen publikisht herë pas herë nga Administrata Tatimore.

11.5 Dispozitat e këtij neni nuk do të aplikohen mbi punëdhënësit që janë organizata qeveritare ndërkombëtare, misione diplomatike ose zyra ndërlidhëse të qeverive të huaja.

Neni 12
Ankesat

Çdo person që ndikohet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga një përcaktim zyrtar i bërë sipas kësaj Rregulloreje mund të bëjë ankesë të përcaktimit në fjalë në përputhje me Rregulloren Nr. 2000/20 të UNMIK-ut dhe aktet shtesë.

Neni 13
Ligji i Aplikueshëm

Kjo Rregullore do të zëvendësojë çdo dispozitë të ligjit të aplikueshëm që nuk është në përputhje me të.

Neni 14
Zbatimi

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm mund të lëshojë direktiva administrative për zbatimin e kësaj rregullore.

Neni 15
Hyrja në Fuqi

Kjo rregullore do të hyjë fuqi më 1 Mars 2002.



Michael Steiner
Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm